



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 78, datë 30.03.2023

PËR

MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS NR. 112, DATË 27.10.2022 "PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE PËR
PUNONJËSIT E INSTITUCIONEVE NË VARËSI TE BASHKISË DURRËS"



Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar; të nenit 113 të Ligjit nr.44/2015, datë 30.4.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore; të nenit 5, shkronja "d" të Ligjit nr.10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve"; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 113, datë 1.3.2023 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi"; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.150, datë 22.12.2022 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2023", si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e disa ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.112, datë 27.10.2022 "Për miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e institucioneve në varësi të Bashkisë Durrës", si më poshtë vijon:

- a) Në Lidhjen nr.1, Tabela B “Punonjësit e sistemit me klasa”, paga bazë mujore që i përket pikave 1,2,3 bëhet 40 000 lekë.
 - b) Në Lidhjen nr.2, Tabela B “Punonjësit e sistemit me klasa”, paga bazë mujore që i përket pikave 1, 2 bëhet 40 000 lekë.
 - c) Në Lidhjen nr.3, Tabela B “Punonjësit e sistemit me klasa”, paga bazë mujore që i përket pikave 2, 3, 4, 5, 6 bëhet 40 000 lekë.
 - d) Në Lidhjen nr.4, Tabela B “Punonjësit e sistemit me klasa”, paga bazë mujore që i përket pikave 1, 2 bëhet 40 000 lekë.
 - e) Në Lidhjen nr.5, Tabela B “Punonjësit e sistemit me klasa”, paga bazë mujore që i përket pikave 1, 2, 3, 4, 5, 6 bëhet 40 000 lekë.
 - f) Në Lidhjen nr.6, Tabela B, “Punonjësit e sistemit me klasa”, paga bazë mujore që i përket pikave 2, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, bëhet 40 000 lekë.
 - g) Në Lidhjen nr.6, pika C, paga bruto mujore për punëtorët sezonal me afat të përcaktuar bëhet 40 000 lekë.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi fillojnë nga data 1 prill 2023. Njësitë shpenzuese efektet financiare për vitin 2023 do t’i përballojnë nga fondet e lira në buxhetin e miratuar për vitin 2023, si dhe nga fondet shtesë, që do t’ju alokohen për këtë qëllim. Fondet shtesë do të sigurohen nga fondet e trashëguara nga viti 2022.
 3. Ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi




U shpall sot me datë 03.04.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 232 /
4 prot.

Durrës, më 06.04.2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
Durrës**

**KRYETARIT TË BASHKISË
Durrës**

0604 23 2560/10

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.78 datë 30.03.2023 “Për miratimin e disa ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Bashkiak Durrës nr. 112, datë 27.10.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e institucioneve në varësi të Bashkisë Durrës””.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

Konc: S.Zeqja
Konf: E.Çato

PREFEKTI

EMILJAN JANI

